



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.12..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 23 / 01 / 2023

VENDIM

Nr.01, datë 23 /01/2023

PËR

**KËRKESËN E MINISTRISË SË MBROJTJES PËR DHËNIE MENDIMI NË LIDHJE ME
VLERESIMIN E RISHIKUAR TE RISKUT NGA FATKEQËSITË NË NIVEL
QËNDROR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 23.01.2023 mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Mbrojtjes për rihënje mendimi në lidhje me projekt vendimin dhe Raportin e konsoliduar të rishikuar për vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC). Në Raportin e rishikuar është marrë në konsideratë sugjerimi i KKDM në mbledhjen e mëparshme për rivlerësimin e raportit të konsoliduar në lidhje me vlerësimin e riskut të fatkeqësive në nivel qendror që lidhen me carjet e digave.

Në mbledhje ishin prezent antarët e KTPD, përfaqësues të AKMC si dhe konsulenti që ka përgatitur Raportin e konsoliduar për vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror në rastin e carjes së digave.

Gjatë diskutimeve, antarët e KKDM theksuan faktin që vlerësimi i riskut në rastin e carjeve të digave duhet të marrë për bazë rekomandimet konkrete të ICOLD për kriteret e dhëna për këtë vlerësim. Sipas këtyre rekomandimeve, vlerësimi i riskut në lidhje me digat bazohet në lartësinë e digave, volumin e rezervuarëve, numrin e njerezve në rrezik që ndodhen në zonat urbane poshte digave si dhe në demet ekonomike që mund të shkaktohen nga prishja e mundshme e një dige. Në diskutimet u konkludua se rritja e nivelit të riskut mesatar të carjes së digave të mëdha në Shqipëri nga 2 në 3.75 është e pranueshme dhe përputhet me nivelin e riskut mesatar të përcaktuar në baze të rekomandimeve të ICOLD. Ky rivlerësim nxjerr në pah rëndësinë e masave që duhet të ndermerren për monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj rivlerësimin e nivelit të riskut për carjet e digave nga 2 në 3.75 në Raportin e Konsoliduar të rishikuar për vlerësimin e Riskut të Fatkeqësive në Shqipëri të përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në lidhje me carjet e digave.
- 2- Ti rekomandoje Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile:
 - Përfshirjen e KKDM në grupet kryesore të interesit (pika 4 e Raportit të konsoliduar) duke u bazuar në detyrat që ka ky institucion sipas legjislacionin në fuqi;
 - Rishikimin e riskut të carjes së digave për prodhim energjie në qarqet Durrës, Gjirokastër dhe Vlorë të dhëna në grafikun përkatës në fig.11 duke qenë se në këto qarqe nuk ka diga të mëdha për prodhim energjie;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Rishikimin e paragrafit të parafundit të pikes 5 të raportit të konsoliduar dhe heqjen e fjalise së fundit të këtij paragrafi duke qene se probabiliteti i carjes së nje dige është e lidhur me gjendjen aktuale të digave, moshën e tyre, sistemet e monitorimit të tyre si dhe mirembajtjen nga shfrytëzuesit e digave. Aktualisht, duke u nisur nga fakti që mosha mesatare e digave në Shqipëri është mbi 40 vjeçare, që sistemet e monitorimit mungojnë në afro 90 % të digave të mëdha si dhe në faktin që mirembajtja e 90 % të digave të mëdha që shfrytëzohen nga bashkitë e vendit është e dobët, duhet të arrihet në përfundim që probabiliteti i carjes së digave të mëdha nuk është i ulët.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

